



DIJALOG

PROCES

PËRFORCIMI

M-r Ana Blazeva

KRIJIMI POLITIKAVE EFEKTIVE GJINORE

QYTETARËT

KOMUNITET

MODEL

KOMUNITET

KRIJIM

Analizë e politikava

Krijimi i Politikave Efektive Gjimore:

Model për përforcimin e dialogut dhe kyçjen e qytetarëve të bashkësisë në procesin e krijimit të politikave të vetëdijëshme gjimore

Botues

Instituti i shkencave shoqërore dhe humane – Shkup

Rruga “20 Oktomvri”, nr.8, kati I dytë

1000 Shkup, Maqedoni

Për botuesin

Katerina Kolozova

Drejtor Ekzekutiv i Institutit i shkencave shoqërore dhe humane – Shkup

Autor

M-r Ana Blazeva

Ekipi që punoi në projektin:

Katerina Kolozova

Marija Savovska

Ana Blazeva

Artan Sadiku

Suzana Grozdanovska

Kalina Lecevska

Viktorija Borovska

Dizajni dhe vizualizimi i të dhënave

Risto Aleksovski

Tirazhi: 500

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека “Св. Климент Охридски”, Скопје

323.21:305(497.7)

352/354:304.9(497.7)

BLAZEVA, Ana

Krijimi i politikave efektive gjimore : model për përforcimin e dialogut dhe kyçjen e qytetarëve të bashkësisë në procesin e krijimit të vetëdijëshme gjimore : analizë e politikava / [autor Ana Blazeva].

- Shkup : Institutit i shkencave shoqërore dhe humane, 2014. - 42 str. ; 21 см

Библиографија: стр. 39-42

ISBN 978-608-4755-02-9

а) Родова застапеност - Креирање политика - Македонија б)

Општествен развој - Локална самоуправа - Родови аспекти - Македонија

COBISS.MK-ID 96707594



United Nations Entity for Gender Equality
and the Empowerment of Women

Ky publikim është pregaditur me përkrahje të zyrës së Kombeve të Bashkuara për barazi gjinore dhe përparim të grave (UN Women) në Shkup. Mendimet dhe qëndrimet e shprehura në këtë publikim janë të autorëve dhe detyrimisht nuk i paraqesin mendimin dhe qëndrimet e UN Women, OKB ose organizatave tjera të përafërta.

Krijimi i Politikave Efektive Gjimore:

Model për përforcimin e dialogut dhe kycjen e qytetarëve të bashkësisë në procesin e krijimit të politikave të vetëdijëshme gjimore

Instituti për Shkenca Shoqërore dhe Humaniste- Shkup shpreh mirënjohje drejt UN Women për besimin e dhënë dhe për mbështetjen financiare për realizimin e projektit dhe për shtypjen e kësajë analize. Shprehim falenderim të madh për të gjithë pjesëmarrësit në realizimin e projektit: organizata partnere Akcija Zdruzhenska, komunën e Strumicës, komunën Gjorçe Petrov, komunën e Bogovinës, organizatat joqeveritare Shoqata për Zhvillim Rural, Shoqata e Grave e Qytetit të Shkupit dhe Shoqata e Grave- Strumicë dhe të gjitha gratë të cilat morrën pjesë në diskutimet dhe në fokus grupet.

Përmbajtja

Hyrje	7
1. Konteksti institucional në Maqedoni dhe në Bashkimin Evropian	8
1.2. Çfarë paraqet krijimi i politikave të përgjegjshme gjinore?	9
2. Konteksti- korniza egzistuese ligjore dhe institucionale	11
2.2. Konteksti ekonomik dhe punësimi/papunësia	13
2.3. Vendimmarrja	14
2.4. Barazia gjinore në Maqedoni e matur në kontekst ndërkombëtar, me shqyrtim të posaçëm- aplikimit të parimeve të barazisë gjinore nga ana e njësive të vetëqeverisjes lokale	15
3. Përshkrim i njërës nga modelet e mundshme për krijimin dhe avancimin e politikave të përgjegjshme gjinore në njësitë e vetëqeverisjes lokale	17
3.1. Rajone të posaçme ku është e nevojshme që të punohet në përforcimin e kapaciteteve për krijimin dhe aplikimin e mekanizmave për avancimin e barazisë gjinore	19
3.1.1. Analizë gjinore në procesin e krijimit të politikave	19
3.1.2. Evaluim i nevojave të qytetarëve përmes veglës së thjeshtë «Kartela për Vlerësimin e Bashkësisë» (Community Score Card ose shkurt CSC)	19
3.1.3. Planifikimi dhe buxhetimi i përgjegjshëm gjinor	22
3.2. Vendosja e bashkëpunimit dhe dialogut me përfaqësues të grupeve të rëndësishme, si dhe forimimi i grupeve punuese	24
4. Rezultate nga aplikimi i modelit	26
4.1 Rrjedha dhe rezultate nga projekti «Përforcimi i kapaciteteve të vetëqeverisjes lokale dhe aktivistëve vendorë për krijimin e politikave efektive për barazi gjinore në R. e Maqedonisë»	26
4.1. Rezultate nga Kartela për Vlerësimin e Bashkësisë– Community Score Card (CSC)	28
5.Konkluzione dhe rekomandime	37
Referenca	39

Hyrje

Analiza është rezultat i projektit Përforcimi i kapaciteteve të vetëqeverisjes lokale dhe aktivistëve vedorë për krijimin e politikave efektive për barazi gjinore në R. e Maqedonisë, të cilin e implementoi Instituti për Shkenca Shoqërore dhe Humane - Shkup, në partneritet me Akcija Zdruzenska-n, mbështetur nga UN Women.

Projekti u realizua në peridhën prej nëntorit të vitit 2012 deri më dhjetor të vitit 2013 me qëllim avancimin e kompetencave të përfaqësuesve të vetëqeverisjes lokale, përfaqësuesëve të administratës dhe anëtarëve të Komisionit për Mundësi të Barabarta për zmadhimin e efikasitetit të tyre sa i përket futjes së çështjeve gjinore në dokumente, politika dhe aktivitete të vetëqeverisjes lokale dhe vendosjes së dialogut mes vetëqeverisjes lokale dhe OJQ-ve lokale dhe aktivistëve. Gjithashtu, projekti kishte për detyrë që të mundësojë krijimin dhe revidimin e politikave dhe dokumenteve sipas nevojave të identifikuara dhe prioriteteve të grave nga bashkësia lokale.

Projekti u realizua në tri komuna të R. së Maqedonisë: Gjorçe Petrov, Bogovinë dhe Strumicë në bashkëpunim me komunat dhe me organizatat joqeveritare Shoqata për Zhvillim Rural, Shoqata e Grave e Qytetit të Shkupit dhe Shoqata e Grave- Strumicë.

Praktikat e mira nga realizimi i projektit mundësojnë krijimin e një Modeli për përforcimin e dialogut dhe kyçjes së qytetarëve të bashkësisë në procesin e krijimit të politikave të vetëdijshme gjinore i cili mund të shërbejë si udhërrëfyes në angazhimin për vendosjen e barazisë gjinore dhe kyçjen e perspektivave gjinore në rrjedhat kyçe, politikat dhe praktikat në njësitë e vetëqeverisjes lokale.

1. Konteksti institucional në Maqedoni dhe në Bashkimin Evropian

Krijimi i politikave efektive për barazi gjinore është në thelb pjesa më e rëndësishme e procesit të vendosjes së barazisë gjinore dhe vendosjes së perspektivës gjinore në rrjedhat kyçe, në politikat dhe nëpraktikat (gender mainstreaming). Në vitin 2010, Parlamenti i Bashkimit Evropian, Këshilli i Evropës dhe trupat e tjerë të Bashkimit Evropian miratuan Strategjinë për Barazinë e Burrave dhe Grave 2010-2015¹ në të cilën i përforcojnë zotimet për garantimin e të drejtave gjinore si fundamentale, eliminimin e pabarazisë dhe promovimin e barazisë mes burrave dhe grave. Në këtë dokument arritja e barazisë gjinore trajtohet si jetësore për zhvillimin e Unionit dhe përforcimit të kohezionit social. Gjithashtu, Strategjia Evropiane 2020², i cili është dokument kyç për zhvillim të mençur, të qëndrueshëm dhe inkluziv, vendos për qëllim zmadhimin e punësimit të grave dhe të burrave për 75% deri më vitin 2020 që nënkupton përmirësimin e parametrave sasiore dhe cilësore të punësimit.

Strategjia Evropiane për Barazinë e Burrave dhe Grave 2010-2015 si lëmi prioritare i veçon- pavarësinë e barabartë ekonomike, punën e paguar në mënyrë të barabartë, barazinë në vendimmarrje dhe ndërprejen e dhunës në baza gjinore.

Kontekstin ndërkombëtar e zgjerojmë që të përmendim dy platformat e Kombeve të Bashkuara të cilat gjithashtu e krijojnë kontekstin në të cilin miratohen politikat e reja për barazi gjinore. Platforma e Pekinit për Aksion me revidimet dhe sesionet vjetore dhe konkluzionet e Komisionit³ dhe Konventa për Eliminimin e Diskriminimit të Grave⁴ të cilat vazhdojnë të jenë determinantë të kahjeve të cilat miratohen në kontekstet nacionale. Në vitin 2006 rekomandimet⁵ e Komisionit për Eliminimin e Diskriminimit ishin të drejtuara kah përforcimi i maqënerisë nacionale dhe mundësisimit dhe përshpejtimit të proceseve në vetëqeverisjen lokale.

Në rekomandimet e fundit⁶ të 2013-ës pritet përforcimi i mëtutjeshëm i maqënerisë nacionale dhe koordinimi në nivelet e ndryshme të vendimmarrjes në institucionet shtetërore si dhe përmirësimimi i implementimit të ligjit dhe përforcimi i proceseve të futjes së politikave në fushën e barazisë gjinore.

Duke shikuar nga kjo perspektivë, është e domosdoshme që Republika e Maqedonisë të vazhdojë me zotimet të cilat i filloi viteve të fundit në planin e vendosjes së kornizës ligjore dhe mekanizmave institucionale bazë për arritjen e barazisë më të madhe gjinore. Këto angazhmane janë më të dukshme në formimin e mekanizmave nacionale ligjore dhe institucionale për vendosjen e barazisë gjinore. Krijimi i politikave efektive është hapi i ardhshëm më i rëndësishëm në vazhdimin e këtyre zotimeve dhe kahëzimit të prioriteteve. Në përputhshmëri me konceptin për futjen e gjinisë në rrjedhat kyçe shoqërore (gender mainstreaming), krijimi i politikave efektive gjinore nënkupton njohuri

dhe shkathtësi për analizë gjinore, buxhetim të përgjegjshëm gjinor dhe për konceptualizimin e nevojave dhe prioritetëve të qytetarëve.

1.2. Çfarë paraqet krijimi i politikave të përgjegjshme gjinore?

Definicioni i futjes së perspektivës gjinore në rrjedhat kyçe, politikat dhe praktikat (gender mainstreaming), siç është e vendosur në Strategjinë për Barazi Gjinore 2013-2020⁷, „paraqet integrimin e perspektivës gjinore në çdo fazë të procesit të ndërtimit, miratimit, zbatimit, vëzhgimit dhe vlerësimit të politikave duke patur parasyshë promovimin dhe avancimin e barazisë mes grave dhe burrave. Kjo do të thotë: (a) vlerësim se si politikat ndikojnë në jetën dhe vendin e gruas dhe të burrit dhe (b) marrjen e përgjegjësisë që të njejtat të adresohen me krijimin e hapsirës për secilin, nga niveli i bashkësisë familjare e deri në nivelin e bashkësisë më të gjërë, të kontribuojë në atë proces të ndërtimit të vizionit të përbashkët dhe të qartë për arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm, që, në fund, (c) t’i kthejnë këto politika në realitet. Që të arrihet kjo, është i domosdoshëm nivel i lartë i vullnetit politik, përkushtim dhe mirëkuptim në të gjitha strukturat dhe sferat e shoqërisë“.

Procesi i krijimit të barazisë gjinore është i komplikuar, ashtu siç është edhe kuptimi dhe vlerësimi i nevojave sa i përket mënyrës se si krijohen politikat në institucionet shoqërore. Definicioni i shfaqur më lartë, gjithashtu, paraqet përshkrim të realitetit të cilin shumica nuk e njohin apo kanë rezistencë t’a njohin, e kjo është që në realitet nuk egziston barazia mes burrave dhe grave. Barazia nominale (në legjislacion dhe në politika të caktuara institucionale) nuk do të thote edhe barazi në realitet. Bindja se barazia nominale dhe realiteti mund të njejtësohen del si rezultat i mungesës së informatave të mjaftueshme, e me këtë edhe të vetëdijes dhe aftësisë për të detektuar (ndjeshmëri gjinore ose gender sensitivity) egzistencën e pabarazisë në të gjitha segmentet e jetesës shoqërore. Përkatësisht, të gjitha hulumtimet, të cilat në aspekte të ndryshme i pasqyrojnë gjendjet reale dhe proceset në R. e Maqedonisë, rezultatet e të cilave janë të shfaqura më poshtë në këtë analizë, nxjerrin në pah egzistencën e pabarazisë gjinore si në sferën e jetës publike ashtu edhe në sferën private. Për këtë arsye, kyçja e nevojave të ndryshme, prioritetëve dhe pozicioneve të burrave dhe grave në politika paraqet një sfidë të madhe për të cilën nuk mjafton vetëm vendosja e korinizës normative të përshtatshme por investim i përpjekjeve dhe resurseve të mëdha në zgjerimin e vetëdijes .Ngritja e vetëdijes, megjithatë, nuk garanton zbatimin e normave dhe vlerave të barazisë gjinore. Vullneti i mirë për zbatimin e këtyre vlerave, duhet të përkthehet në politika institucionale dhe kapacitete të formuara të cilat paraqesin një sërë masash proaktiviteti sa i përket barazisë gjinore, të inkorporuara në çdo sferë të shoqërisë, funksionimin e të cilës e rregullojnë.

Andaj, në nivel lokal, krijimi i politikave senzitive gjinore është i domosdoshëm

sepse mundëson pjesëmarrje të drejtëpërdrejtë të qytetarëve dhe në këtë mënyrë e lehtëson procesin e identifikimit të nevojave të posaçme të qytetarëve (grave dhe burrave) të bashkësisë, por gjithashtu e mundëson edhe adresimin e tyre përmes krijimit të mekanizmave dhe shërbimeve të posaçme.

Faza fillestare e këtij hulumtimi në kuadër të këtij projekti, e cila zhvillohej në formën e diskutimeve në stuhi (brainstorming), dhe kishte për qëllim vlerësimin e nevojave, tregoi që përfaqësues të vetëqeverisjes lokale besojnë që të ashtuquajturat politika gjinore neutrale janë më të drejtat. Ata bazohen në supozimin se qëllimet dhe instrumentet e politikave të dhëna i'u referohen të gjithëve në mënyrë të barabartë, pa marrë parasysh efektet (e mundshme) të ndryshme të cilat një politikë mund ti ketë mbi gratë dhe burrat në shoqëri, gjegjësisht mbi nevojat dhe pozicionet e tyre të posaçme. Supozimi se pozicionet fillestare të burrave dhe grave në shoqëri, rrethanat e tyre të dukshme dhe mundësitë konkrete përjashtohen plotësisht, ndërsa institucionet e zbatojnë punën e tyre në përputhshmëri me ndonjë pasqyrë ideale për barazinë ashtu siç është e hartuar ajo nëpër ligjet. Në këtë kuptim, është e rëndësishme të theksohet se thënia "Ka ligje të mira, por nuk ka zbatim" ishte e përdorur shpesh, që do të thotë se nuk detektohet nevoja për krijimin e politikave të cilat do të mundësojnë zbatimin e ligjeve. Me fjalë të tjera, mungon vetëdija se që të mund ligjet të shëndrrohen në realitet mungojnë politika të institucioneve të cilat do t'i zbatonin ato. Ky konstatim për gjendjet i referohet konceptit dhe praktikës së krijimit të politikave në përgjithësi nga ana e administratës lokale si dhe zbatimit të tyre. Kjo udhëzon për nevojën e zhvillimit të një programi edukativ me model të vetin trajnimesh të cilat do të ofrojnë ngritjen e kapaciteteve dhe model për qëndrueshmërinë e tyre, me investim të vazhdueshëm në forcimin e kapaciteteve në njësitë e qeverisjes lokale, sa i përket vetëdijes për nevojën e krijimit të politikave si instrument i vetëm efektiv në shëndrrimin e normës në praktikë.

Në procesin e krijimit të politikave, norma kërkon që parimi i mundësive të barabarta për burrat dhe gratë të jetë i integruar. Për këtë arsye, me qëllim që norma të shëndrrohet në realitet (ose që të respektohet) krijuesit lokal të politikave dhe programeve duhet që të aftësohen. Që këtu, si pjesë e proceseve të aftësimit për krijimin e politikave, duhet që të zbatohen edhe trajnime për krijimin e politikave gjinore senzitive. Këto trajnime duhet t'i aftësojnë përfaqësuesit e administratës lokale që të detektojnë domosdoshmërinë për ndryshimin e tërë procesit të krijimit të politikave, por edhe që t'iu përgjigjen detyrave të rregullativës ligjore, në të cilat specifikim kyç do të ishte kahëzimi i vazhdueshëm drejt nevojave dhe pozicioneve të ndryshme të burrave dhe grave sa i përket kësajë teme. Kjo nënkupton:

a) fazë përgatitore e cila do të përbëhet nga kyçja e të ashtuquajturës analizë gjinore në procesin e hulumtimit të nevojave dhe prioriteteve si dhe analizë e efekteve nga politikat egzistuese ose të planifikuara, e gjithashtu

b) kyçjen e perspektivës gjinore në procesin e planifikimit dhe buxhetimit si pjesë e pandashme e procesit të krijimit dhe miratimit të politikave i cili cakton pa/barazinë e distribuimit të resurseve dhe ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në efektivitetin e politikave.

c) dialogun mes institucioneve dhe qytetarëve, përmes përfaqësuesve dhe avokuesve të tyre në organizatat qytetare, aktivistëve, por edhe përmes pjesëmarrjes individuale të qytetarëve në procesin e krijimit të politikave. Përveç se paraqet respektim thelbësor të parimeve demokratike në procesin e krijimit të politikave, ndërtimin e dialogut me qytetarët, gjithashtu, mundëson që në mënyrë direkte të ndiqen dhe të kihen parasyshë nevojat dhe prioritetet reale si dhe të vërehen pozitat e ndryshme të cilat burrat dhe gratë i kanë.

Decentralizimi i qeverisjes përmes njësive të vetëqeverisjes lokale mundëson pikërisht këtë proces të krijimit demokratik të politikave të cilat në thelb duhet të pasqyrojnë nevojat e grave dhe burrave në bashkësi dhe në atë mënyrë t'i zbatojnë normat e vendosura ligjore për barazi gjinore.

2. Konteksti- korniza egzistuese ligjore dhe institucionale

Përshkrimi i kontekstit përfshin dispozita ligjore dhe praktika institucionale që kanë të bëjnë me avancimin e barazisë gjinore si dhe vrotimet për proceset e avancimit së barazisë gjinore nga hulumtimet e realizuara viteve të fundit.

Korniza më e gjërë ligjore i vendos bazat e barazisë gjinore- në Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë⁸ në nenin 9 garantohen liritë dhe të drejtat e qytetarëve pavarësisht gjinisë, racës, ngjyrës së lëkurës, originës kombëtare dhe sociale, bindjes politike dhe religjioze, gjendjes pronësore dhe shoqërore. Zbatimi praktik i konceptit të vendosjes së mundësive të barabarta ka filluar qysh në vitin 1999 kur për herë të parë është miratuar Plani Nacional për Aksion për Barazi Gjinore.

Në vitin 2006, Republika e Maqedonisë sjellë të parin Ligj për Mundësi të Barabarta të Grave dhe Burrave, edhe pse në më shumë ligje të tjera, gjithashtu, janë përcaktuar norma të lidhura me ndalimin e diskriminimit gjinor⁹. Me këtë ligj përcaktohet nevoja për egzistencën e masave të posaçme bazë për vendosjen e mundësive të njejta për gratë dhe burrat; dhe kompetencat , detyrat dhe përgjegjësitë e të gjitha subjekteve të përgjegjësme për implementimin e këtijë

Ligji; si dhe të drejtat dhe detyrimet e përfaqësuesëve të mundësive të njejtë të grave dhe burrave. Në vitin 2008 ligji u ndryshua si rezultat i harmonizimit të legjislativës maqedonase me legjislativën e Bashkimit Evropian e cila e rregullon trajtimin e pabarabartë të grave dhe burrave. Ndryshime janë bërë edhe në pjesën me dispozitat penale të cilat qenë rezultat i ndryshimeve të Ligjit për Shkelje.

Ndryshimet e fundit të Ligjit¹⁰ (neni 11, 12, 13) të miratuara në vitin 2012 janë në pjesën e cila ka të bëjë me detyrat dhe rolet e subjekteve relevante në drejtim të precizimit dhe dhe përforcimit të përgjegjësisë të të gjithë aktorëve në proceset e futjes së perspektivës gjinore në rrjedhat e rëndësishme shoqërore (gender mainstreaming).

Sipas nenit (14, 15) të Ligjit për Mundësi të Barabarta të Burrave dhe Grave, njësitë e vetëqeverisjes lokale, përveç aktorëve të tjerë relevantë, janë përgjegjës edhe për vendosjen dhe promovimin e mundësive të barabarta të burrave dhe grave përmes miratimit të politikave, mekanizmave dhe aktiviteteve të cilat do të kontribuojnë kah avancimi i barazisë gjinore. Njësitë për vetëqeverisje lokale duhet të raportojnë në kuadër të raporteve të tyre vjetore dhe të marrin pjesë në përgatitjen e strategjisë për barazi gjinore në pjesën sa i përket njësive të vetëqeverisjes lokale. Ligji, gjithashtu, jep udhëzimet për vendosjen e “maqinerisë” gjegjësisht strukturës dhe roleve të organeve të vetëqeverisjes lokale, formimin e Komisionit për Mundësi të Barabarta për Burrat dhe Gratë (neni 14,15).

Çështja e barazisë gjinore, promovimit dhe mbrojtjes së mundësive të barabarta, është mundësuar më tej edhe me miratimin e Ligjit për Ndalimin e dhe Mbrojtjes nga Diskriminimi¹¹ i cili paraqet kornizë ligjore për mbrojtjen nga diskriminimi në baza të ndryshme.

Në Ligjin për Mardhënie Pune¹² është futur parimi i ndalimit të diskriminimit gjatë punësimit (neni 6), ndalimi për diskriminim direkt ose indirekt në vendin e punës (neni 7), për ngacmim ose ngacmim seksual (neni 9). Me këtë ligj garantohen kushtet e njejtë për zhvillim profesional dhe avancim, si dhe rrogë të njejtë për punë të njejtë (neni 108). Në Kodin Zgjedhor¹³ futet parimi i përfaqësimit adekuat, ligjor dhe gjinor në organet zgjedhore (neni 21) me atë se rregullohet me ligj përfaqësimi i çdo gjinie me më së paku 30%. Kodi Zgjedhor nuk parasheh kuota për zgjedhjen e kryetarëve të komunave ose masa të posaçme për mundësimin e pjesëmarrjes së barabartë të grave dhe burrave në pushtetin egzekutiv.

Në vitin 2013 Kuvendi i Republikës së Maqedonisë miratoi Strategjinë për Barazi Gjinore 2013-2020¹⁴ si dokument të fundit strategjik të Republikës së Maqedonisë, i cili miratohet me qëllim që të avancohen mundësitë e barabarta të grave dhe burrave në jetësën e përgjithshme shoqërore në Republikën e Maqedonisë. Kjo strategji paraqet dokument “i cili mundëson kornizë për barazi të plotë të grave dhe burrave si prioritet kros-sektorial, horizontal,

social univerzal dhe politik.” Gjithashtu, ky dokument do ti vendosë hapat bazë dhe kahjet specifike për arritjen e plotë të barazisë gjinore në Republikën e Maqedonisë.

E tërë kjo tregon për egzistencën e kushteve normative për vendosjen e barazisë gjinore, por hulumtimet tregojnë se implementimi i ligjit dhe gjendja de fakto është gjendje e pabarazisë gjinore në të cilën gratë janë më të kufizuara dhe më pak të kyçura në proceset shoqërore. Kjo, edhe pse është konstatim i përsëritur shpesh në hulumtimet e mëparshme ose kontekst analizat, si dhe në dokumenetet strategjike siç është Strategjia për Barazi Gjinore 2013-2020, është e nevojshme të konstatohet edhe njëherë edhe të shërbejë si pikënisje për sugjerimin e modeleve konkrete të cilat mund të kontribuojnë për përmirësimin e gjendjes së konstatuar. Pabarazitë të cilat i nxjerrin në pah hulumtimet mund të jenë pikënisje për definimin e problemeve dhe prioriteteve dhe mund të ndihmojnë në markimin e fushave në të cilat është i nevojshëm krijimi i politikave efektive gjinore. Në nivel nacional, tashmë bëhen hapa të caktuara për identifikimin e pikave hyrëse për integrimin e perspektivës gjinore në procesin e krijimit të politikave (përmes masave rregullative dhe jorregullative) dhe buxhetimit, si dhe zhvillimit të doracakëve dhe moduleve për administratën shtetërore për gender mainstreaming. (mund të përmendet edhe analiza e procesit buxhetor nga perspektiva gjinore, doracaku për buxhetim gjinor dhe metodologji, në proces e sipër është finalizimi i doracakut për GM në proceset e krijimit të politikave në nivel kombëtar).

2.2. Konteksti ekonomik dhe punësimi/papunësia

Në Raportin e Komisionit Evropian për Progresin kah Barazia e Burrave dhe Grave 2010¹⁵, raportohet se egziston hendek mes punësimit të burrave dhe grave dhe se ai hendek në shtetet të cilat nuk janë anëtare të Bashkimit është më i madh, sidomos për gratë më të marginalizuara si psh. gratë rome. Sipas raportit të njejtë në Republikën e Maqedonisë egziston përqindje e ulët e aktivitetit tek gratë prej 44,7% dhe e punësimit prej 30,9% në vitin 2012. Të njejtën e konfirmojnë edhe të dhënat nga Enti për Statistikë i R. së Maqedonisë¹⁶ për vitin 2013 nga popullata aktive 59.7% janë burra, ndërsa 40.3% janë gra. Nga numri i përgjithshëm i të punësuarve, 39.5 % janë gra, ndërsa burrat janë 60.5%. Sa i përket popullatës joaktive, përqindja tek gratë është 37.2%, ndërsa tek burrat 62.8%. Nga shqyrtimi i bërë i aktiviteteve qëndrore në fushën e punësimit, numri i grave të targetuara me programet aktive dhe masat për punësim është simbolike në raport me numrin e përgjithshëm e grave të papunësuar¹⁷. Arsytet për përqindjen e ulët të punësimit të gratë gjenden edhe në vështirësitë për balansimin dhe menaxhimin me sfidat e punës, familjes dhe jetës private. Andaj janë të nevojshme shërbime më cilësore por edhe më të qasshme lidhur me kujdesin për fëmijët dhe anëtarët e familjes si dhe me punën shtëpiake të cilat

do të ju mundësojnë grave të kenë mundësi të barabarta sa i përket zgjedhjes ose avancimit në punë dhe karrierë.

Analiza buxheto-gjinore e mbrojtjes sociale dhe politikave aktive për punësim në Republikën e Maqedonisë¹⁸ të cilën e zbatoi Ministria për Punë dhe Politikë Sociale në vitin 2010, gjithashtu tregon se “Pabarazitë specifike pasqyrohen edhe në matjen e punës së grave sidomos në domenin e punës së papaguar i cili shpesh hy në ekonominë e zezë. Anëtarë ndihmës të familjes janë kryesisht gratë të cilat njëkohësisht nuk janë bartëse të mallit ose çfarëdoqoft aktiviteti, më shpesh joaktive me punë dhe paraqesin vetëm fuqi punëtore potenciale por të papërdorur në shoqëri për shkak të sjelljes tradicionale dhe kuptimit të rolit të gruas në familje dhe në shoqëri , e cila akoma, edhe në këtë shekull është çuditërisht shumë e zgjeruar. Vetëm sa për ilustrim, në pjesën sa i përket punësimit sipas statusit ekonomik, pjesëmarrja e grave si punëdhënëse është 21%; nga ato vetëm 17% janë të vetë-punësuar, por në 60% të rasteve ato figurojnë si punëtore familjare të papaguara në vitin 2006,” (fq. 17).

2.3. Vendimmarrja

Fushë tjetër e cila gjithashtu është një nga më të rëndësishmet për vendosjen e barazisë gjinore është barazia e grave dhe burrave në proceset e vendimmarrjes. Raporti nga Monitorimi i Politikave për Barazi Gjinore në R. e Maqedonisë tregon se në shtresat e larta të hierarkisë, në pozita politike dhe ekonomike, gjithmonë dhe gjithëandëj ka më pak gra se burra. Në vetëm 3% të kompanive më të mëdha gratë janë të përfaqësuara në organet me nivel më të lartë të vendimmarrjes¹⁹. Në Maqedoni, sa i përket përfaqësimit të grave në proceset e marrjes së vendimeve në sferën politike nga numri i përgjithshëm i vendeve të deputetëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, gratë janë të përfaqësuara me 30,8%, nga gjithësej numri i ministrave (19) dy janë gra dhe vetëm Një është zëvendës-ministre. Ndërsa ka vetëm katër gra nga numri i gjithësejtë (80) i kyetarëve të komunave²⁰.

Në një pjesë të komunave, gratë nuk marrin pjesë aspak në punën e bordeve egzekutive ose janë shumë pak të përfaqësuara. Shprehur me shifra, nga 68 komuna, 158 gra janë anëtare të bordeve egzekutive kundrejt 483 anëtarëve burra. Analiza tregon se gratë thuajse nuk figurojnë si kryetare të bashkësive urbane. Nga gjithsej 68 komuna, vetëm në 13 gratë paraqiten si kryetare të bashkësive rurale/urbane.²¹ *

Sipas analizës për shkallën e implementimit të Ligjit për Mundësi të Barabarta të Grave dhe Burrave²² në domenin e kompetencave të Avokatit të Popullit dhe analizës së gjendjes së barazisë gjinore në organet shtetërore, gjyqet, pushtetin egzekutiv, institucionet shëndetësore, ndërmarrjet publike, shërbimet,

* të dhënat janë nga analiza e fundit për pjesëmarrjen e femrave në jetën publike dhe politike e bërë nga Ministria e punës dhe politikës sociale në vitin 2011, në mungesë të analizës për gjendjen e re në njesitë për qeverisjen lokale mbas zgjedhjeve të vitit 2013.

agjencionet dhe në institucionet arsimore, egziston pabarazi gjinore në distribuimin e vendeve udhëheqëse të punës mes grave dhe burrave. Avokati i Popullit gjatë analizës së të dhënave, konstaton se përskaj zotimeve të shtetit për krijimin e kushteve normative dhe praktike për barazi mes grave dhe burrave vazhdon të egzistojë pabarazi. (Analiza për shkallën e implementimit të Ligjit për Mundësi të Barabarta të Grave dhe Burrave, MPPS, 2011)

2.4. Barazia gjinore në Maqedoni e matur në kontekst ndërkombëtar, me shqyrtim të posaçëm- aplikimit të parimeve të barazisë gjinore nga ana e njërive të vetëqeverisjes lokale

Në Raportin për Henedekun Global mes Gjinive²³ të vitit 2012, në të cilin llogaritet në nivel global indeksi i hendekut në katër fusha- pjesëmarrje ekonomike dhe mundësi, arsim, shëndetësi dhe mbijetesë, dhe politikë, Maqedonia në vitin 2012 ka indeks 0.6968 dhe gjendet në vendin e 61 nga gjithësej 135 shtete të ranguara. Kjo do të thotë se ka ndodhur rënie prej 8 pozitave në krahasim me vitin e mëparshëm. Në raportin thuhet se Maqedonia përparon sa i përket përqindjes së grave në pozita ministrash por kjo nuk e balanson rënien në barazinë e rrogave dhe uljen e të ardhurave. Gjithashtu, Maqedonia është njëri nga katër shtetet e rajonit i cili ka vlera nën mestaren të sub-indeksit për shëndetësi dhe mbijetesë.

Hulumtimi Indeksi për Përfshirje Sociale²⁴ (2010) tregon efikasitet dhe përgjegjësi të ulët të njërive të vetëqeverisjes lokale lidhur me promovimin dhe implementimin e mundësive të barabarta të burrave dhe grave. Rezultatet e hulumtimit tregojnë se akoma egzistojnë komuna të cilat nuk kanë formuar komisione për mundësi të barabarta të grave dhe burrave ose egzistenca e tyre reduktohet në formalitet, ndërsa më pak se gjysma prej tyre nuk kanë asnjë lloj dokumenti strategjik. Nga ana tjetër, është e rëndësishme të vihen re edhe komunat në të cilat janë bërë hapa të caktuara dhe në të cilat trupat e formuara janë aktive duke miratuar dokumente strategjike. Kështu psh. Qyteti i Shkupit krijoi Strategji për Barazi Gjinore të veten, në të cilën shfaqet zotimi për futjen e gjinisë në politikat dhe mekanizmat aktual të komunës, ndërsa komuna e Manastirit krijoi plan aksioni të vetin. Gjithashtu, këtu numrohen edhe pilot komunat e përfshira në këtë projekt, komuna e Strumicës, Bogovinës, dhe Gjorçe Petrovit të cilat kanë krijuar programe dhe plane aksioni për barazi gjinore.

Ky hulumtim e konfrimon gjendjen të cilën në vitin 2009 e shpalli organizata Akcija Zdruzenska në të vetin Monitorim të implementimit të Ligjit për Mundësi të Barabarta të Burrave dhe Grave në njësitë e vetëqeverisjes lokale²⁵. Analiza e tyre cilësore tregon se vlerësim i përgjithshëm i vetë kryetarëve të komunave është se egziston nivel i ulët i zbatimit të Ligjit. Disa nga kryetarët e komunave as nuk e cilsojnë si çështje të rëndësishme barazinë gjinore dhe

punën në drejtim të vendosjes së barazisë gjinore e reduktojnë në numërimin e burrave dhe grave të cilët janë të punësuar në komunë. Në raportin e Akcija Zdruzhenskës nga monitorimi i politikave për barazi gjinore në Republikën e Maqedonisë, konfirmohet se komunat nuk tregojnë iniciativë për kyçjen e çështjeve gjinore në proceset, politikat dhe aktivitetet të cilat i realizojnë, psh. 70% e komunave nuk kanë program për punë, ose se vetëm 37% e kryetarëve të komunave kanë përgatitur përshkrim të detyrave të punës të koordinatorit për mundësi të barabarta të grave dhe burrave²⁶. Gjithashtu, egziston bashkëpunim i pamjaftueshëm mes komunave dhe organizatave joqeveritare, partnerëve social dhe përfaqësuesve të tjerë të bashkësisë, por akoma më i vogël është bashkëpunimi mes kryetarit të komunës, gjegjësisht administratës dhe KMB-ës. Në raportin përfundohet se, implementimi i Planit Nacional për Aksion për Barazi Gjinore 2007-2012 përmes implementimit të planeve operative, nuk është efikas. Si arsye për mospësuksin e supozimeve të përealizuara për implementimin e tyre, thuhet se nuk egziston transformim real në procesin e krijimit, zbatimit dhe implementimit të politikave dhe masave si parakusht për implementimin e masave. Mospërputhje dhe vërejtje referohen edhe sa i përket mungesës së perspektivës gjinore në krijimin e politikave psh. në domenet e mbrojtjes sociale dhe programeve për punësim të cilat janë në domenin e sferës sociale, dhe të cilat dalin nga Strategjia për Zvogëlimin e Varfërisë dhe Përrjashtimit Social²⁷.

Në domenin e mbrojtjes nga dhuna egziston dukshmëri më e madhe sa i përket problemit të dhunës familjare. Vërehen tentativa për vendosjen e mekanizmave për zvogëlimin e saj dhe mbrojtjen e viktimave, por akoma një pjesë e madhe e këtyre mekanizmave nuk funksionojnë dhe nuk arrijnë deri te shtresat më të ndjeshme shoqërore.

Në Analizën sa i përket shkallës së implementimit²⁸ të Ligjit për Mundësi të Barabarta të Grave dhe Burrave në Ministrinë për Punë dhe Politikë Sociale, thuhet se “konform nenit 15 të Ligjit, Avokati i Popullit është i autorizuar në kuadër të kompetencës së tij të verifikuar me ligj të kujdeset për arritjen e parimit të mundësive të barabarta të grave dhe burrave dhe të mundësojë mbrojtje kur ndonjë e drejtë e dikujt është shkurtuar apo kufizuar nga ndonjë organ ose organizatë për të cilën është kompetent të veprojë. Deri më tani përpara Avokatit të Popullit në lidhje me zbatimin, gjegjësisht për shkak të cënimit të të drejtave të përcaktuara me këtë Ligj, nuk janë dorëzuar ankesa për mbrojtjen e të drejtave individuale.” Kjo nxjerr në pah përdorimin jashtzakonisht të ulët të mekanizmave të cilat janë në dispozicionin e qytetarëve, e kjo mund të jetë rezultat i informimit të dobët të qytetarëve për mundësitë të cilat i kanë për arritjen e të drejtave të tyre si dhe rezultat i vetëdijes dhe përvojës së ulët demokratike.

3. Përshkrim i njërës nga modelet e mundshme për krijimin dhe avancimin e politikave të përgjegjshme gjinore në njësitë e vetëqeverisjes lokale

Përfundimi i të gjitha hulumtimeve dhe të dhënave të mëparshme është se edhe pse egziston kornizë ligjore për vendosjen e barazisë gjinore, implementimi i ligjeve nuk është i kënaqshëm. Gjithashtu, konstatohet se egziston nevoja për përforcimin e mekanizmave të zbatimit të ligjit parakushti i të cilit është përforcimi i kapaciteteve për krijimin e politikave të cilët do të mundësojnë një gjë të tillë. Në nivel nacional bëhen hapa të para të caktuara përmes Qëllimit strategjik 1 nga Strategjia për Barazi Gjinore (e përmendur më parë).

Në këtë analizë do të fokusohemi në të dhënat të cilat i'u referohen kompetencave dhe zbatimit të ligjit në njësitë e vetëqeverisjes lokale dhe do të propozojmë model për udhëheqjen e procesit të krijimit të politikave efektive gjinore në nivel lokal të cilat do të mundësojnë përmirësim de facto të barazisë gjinore në shoqëri.

Duke marrë parasysh kontekstin, është zhvilluar model i posaçëm për vendosjen e dialogut dhe kyçjes së qytetarëve të bashkësisë në krijimin e politikave të vetëdijëshme gjinore.

Modeli përmban proces të:

- Përforcimit të kapaciteteve;
- Vendosjes së bashkëpunimit dhe dialogut me përfaqësues të grupeve relevante;
- Evaluimit të hulumtimit të nevojave të qytetarëve në proceset e planifikimit dhe krijimit të politikave;
- Krijimit dhe revidimit të politikave/programeve/dokumenteve;

Nga hulumtimet del se egziston mungesë vetëdijeje dhe kuptim i çështjeve gjinore, e cila sjellë deri te efikasiteti i dobët i zbatimit të Ligjit nga ana e njësisë të vetëqeverisjes lokale. Më tutje, kapacitetet e dobëta të administratës komunale për krijimin e dokumenteve strategjike dhe për planifikim, së bashku me mungesën e vetëdijes për çështjet gjinore, i vështirson proceset e kyçjes së gjinisë në rrjedhat kyçe shoqërore. Mu për shkak të mungesave të këtylla, hapi i parë kah krijimi i politikave është i drejtuar kah përforcimi i përfaqësuesve të administratës, përfaqësuesve të Komisionit për Mundësi të Barabarta dhe përfaqësuesve të aktivistëve dhe të organizatave joqeveritare. Në procesin e

përforcimit të kapaciteteve, veçojmë disa aspekte të cilat mendojmë se duhet të jenë fusha kyçe për edukim:

- ngritja e vetëdijes për rëndësinë e parimeve dhe vlerave që janë në thelbin e koncepteve për vendosjen e barazisë gjinore;
- përgjegjësitë të cilat burojnë nga Ligji për Mundësi të Barabarta;
- zhvillimi i shkathtësive për zbatimin e veglave konkrete për analizë gjinore, njohurive dhe shkathtësive për integrimin e perspektivës gjinore në planifikim dhe buxhetim;
- statistikë e veçuar gjinore- e rëndësishme për mbledhjen dhe analizën e të dhënave;
- krijimi i politikave dhe dokumenteve strategjike;
- shkathtësi për përfaqësim/avokim dhe negociata.

Procesi i ngritjes së vetëdijes për parimet dhe vlerat të cilat janë bazë e luftës për barazi gjinore, nënkupton përpunimin e çështjeve të cilat e mundësojnë pranimin e gjendjes së pabarazisë gjinore si normale dhe mekanizmat strukturorë të cilët e mirëmbajnë atë. Mu për shkak të nevojës së detektimit të padukshmërisë strukturore kundrejt barazisë nominale ose patriarkatit si ideologji, pamjes së botës në të cilën njëra gjini (seks) i është nënshtruar tjetrës dhe si gjendje e cila edhe sot e kësaj dite është dominante edhe në shoqëritë ku gjinitë nominalisht janë të barabarta (në demokracitë dhe ekonimitë e zhvilluara njejtë si në ato të pazhvilluara gjinia femërore është disproporcionalisht më e varfër se ajo mashkullore: të dhëna të marra nga Britania e Madhe, India, Ballkani nga burime të ndryshme, përfshirë studimet e UN Women në temën e feminizimit të varfërisë.)²⁹ Për tu arritur zotimi feminist si vlerë shoqërore, është e nevojshme të sqarohet se barazia gjinore nuk është esencë e garantuar vetëvetiu, por e drejtë e fituar e cila duhet vazhdimisht të avancohet dhe të përforcohet.

3.1. Rajone të posaçme ku është e nevojshme që të punohet në përforcimin e kapaciteteve për krijimin dhe aplikimin e mekanizmave për avancimin e barazisë gjinore






3.1.1. Analizë gjinore në procesin e krijimit të politikave

Analiza gjinore si pjesë qendrore e procesit të kyçjes së perspektivës gjinore në rrjedhat kyçe, politikat dhe praktikat (gender mainstreaming), nënkupton hulumtimin e gjendjes aktuale të relacioneve gjinore, analizën e treguesve statistikorë bazë, si dhe vlerësimin e rezultateve të aktiviteteve/proekteve/ programeve/politikave mbi barazinë gjinore e cila do të shërbejë si bazë për planifikim dhe zhvillim. Analiza gjinore, gjithashtu, duhet të jetë pjesë e procesit të planifikimit dhe buxhetimit strategjik si dhe pjesë e evaluimit dhe e dhënies së llogarisë së institucioneve përpara qytetarëve. Gjegjësisht, rishqyrtimi i vazhdueshëm i planeve, efekteve dhe proceseve në lidhje me atë se nevojat e kujtë janë prioritet, në çfarë mënyre përdoren resurset, a është aspekti gjinor, pabarazia e kyçur në qëllimet programore etj. Analiza gjinore mundëson që të fitohet pasqyrë e qartë për nevojat dhe ndikimet e politikave dhe programeve egzistuese. Kur flasim për kyçjen e analizës gjinore në proceset dhe politikat e njësive të vetëqeverisjes lokale, kjo nënkupton se procesi i krijimit të politikave dhe dokumenteve duhet të inkorporojë edhe procesin e analizës gjinore duke u nisur nga nevojat e ndryshme të burrave dhe grave në bashkësinë lokale të cilat pastaj do të mund të pasqyrohen në programet, buxhetin, shërbimet dhe aktivitetet e komunës. Në këtë drejtim është e nevojshme që krijuesit e politikave të cilët janë pjesë e administratës komunale në proceset e krijimit të ndërmarrin hapat e analizës gjinore siç vijon:

- Analizë e politikave/programeve dhe ndikimit të tyre në çështjet gjinore
- Analizë e alokimeve (shpërndarjeve) buxhetore
- Ndjekje të shpenzimeve dhe sigurimit të shërbimeve

3.1.2. Evaluim i nevojave të qytetarëve përmes veglës së thjeshtë “Kartela për Vlerësimin e Bashkësisë” (Community Score Card³⁰ ose shkurt CSC)

Në modelin e udhëheqjes së procesit të krijimit të politikave efektive gjinore të cilin e sugjerojmë, analiza gjinore komplementohet me proces të vlerësimit të nevojave të qytetarëve përmes një qasjeje parcticipative të vlerësimit të nevojave (needs assessment). Për evaluim përdoret vegla Kartelë për Vlerësimin

Infrastruktura- Qasja e grave deri te infrastruktura bazë, shërbimet komunale (fuqizimi i me ujë, ndriçimi, transporti publik, katalizimi)		
Indikator	Notë përmblendhese	Përshkrim i gjendjes
1. Shumica e grave nuk kanë qasje deri te infrastruktura bazë		
2. Vetëm një pjesë e grave (qytet, qendër) kanë qasje derite infrastruktura bazë		
3. Shumica e grave kanë qasje por jo për të gjitha shërbimet		
4. Shumica e grave kanë qasje derite infrastruktura bazë përveç grave me hendikap ose grave nga grupet e tjera të marginalizuara		
5. Të gjitha gratë kanë qasje derite infrastruktura bazë		

teknikë hibride të revidimit shorëror, monitorimit të bashkësisë dhe kartelës për raport të qytetarëve. E tërë qasja e CSC-ës paraqet instrument me të cilin matet përgjegjësia sociale dhe publike, dhe njëkohësisht thirje që të marrin përgjegjësi dhënësit e shërbimeve, gjegjësisht pushteti lokal. Njerëzit e bashkësisë i vlerësojnë shërbimet, si dhe dhënësit e shërbimeve duke shfrytëzuar një sistem të thjeshtë të gradimit në formën e pikëve.

Gjatë takimeve mes dhënësve të shërbimeve dhe bashkësisë, CSC-ja shërben si vegël e cila e përforcon komunikimin dhe mundëson informatë kthyesë të drejtpërdrejtë.³² CSC-ja është posaçërisht e rëndësishme sepse ndërthen disa vlera bazë: pjesëmarrje, përgjegjësi sociale, transparencë dhe barazi. Më shpesh, CSC-ja përdoret me qëllim që të fitohen të dhëna për atë se si e perceptojnë përdoruesit: cilësinë e shërbimeve, transparencën, efikasitetin; si dhe për detektimin e pikave të dobëta të cilat duhet të përmirësohen në dhënien e shërbimeve. Gjatë tërë këtijë procesi, është e rëndësishme të përmendet se me përdorimin e CSC-ës kanë dobi të gjithë: edhe anëtarët e bashkësisë edhe pushteti lokal.

Përdorimi i vëlgës Kartela për Vlerësimin e Bashkësisë (Community Score Card – CSC), e përforcon zërin qytetar, e promovon pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimet në nivel lokal, dhe njëkohësisht krijon mundësi të vërteta për një pjesëmarrje më të gjërë nga grupet e marginalizuara, sidomos të grave, duke ju mundësuar përfaqësim gjinor të barabartë në cilësinë e shërbimeve publike. Njëkohësisht, CSC-ja bashkësisë i mundëson:

- që të shfaqë mendim dhe qëndrim për cilësinë dhe efektet e shërbimeve publike;
që të monitorojë përmbushjen e detyrave të pushtetit lokal sa i përket përcaktimit të shërbimeve cilësore;
- që t'i drejtojë qëndrimet e veta drejtpërdrejtë kah pushtetet relevante sa i'u përket shërbimeve të zbatuara, si dhe mundësinë që t'iu drejtohet që të ata pastaj të bëjnë përmirësimet e domosdoshme;
- interaksion me pushtetet për arritjen e cilësisë dhe shërbimeve të qëndrueshme

Nga ana tjetër, përdorimi i CSC-ës ju mundëson pushteteve lokale:

- kuptim më të mirë për nevojat dhe prioritetet e bashkësisë në nivel të përgjithshëm, si dhe të grupeve të veçanta;
- të shpërndajnë më mirë resurset e disponueshme, duke patur parasysh nevojat dhe prioritetet e bashkësisë;
- përmirësim të kapaciteteve të tyre, udhëheqje transparente dhe përmirësim të cilësisë dhe efikasitetit të shërbimeve të destinuara për bashkësinë

Karakteristika kryesore e Kartelës për Vlerësimin e Bashkësisë është se ajo e merr bashkësinë si njësi në analizë, duke mundësuar dialog mes anëtarëve të bashkësisë dhe përfaqësuesve të pushtetit lokal. Informatat fitohen përmes diskutimeve dhe fokus grupeve të cilat mundësojnë monitorim në nivel lokal. Përfitimi kryesor nga përdorimi i CSC-ës është mundësia të zbulohen njohuritë e pamjaftueshme të përdoruesve/qytetarëve për mundësitë të cilat i ofron komuna, si dhe formimi i strategjive me qëllim që të tejkalohen këto lëshime. Të dhënat e fituara përdoren për zhvillimin e dialogut mes qytetarëve dhe bashkësisë lokale. Më tutje, shqyrtohen mundësitë për përmirësimin e krijimit efikas dhe zbatimit të politikave. Para përdorimit të Kartelës për Vlerësimin e Bashkësisë, është e domosdoshme që të:

- shihet konteksti socio-politik;
- kuptohet struktura e financimit publik në nivel të decentralizuar;

- vlerësohet kompetenca teknike;
- nxitet pjesëmarrje tek qytetarët;
- ndërmerren hapa për institucionalizimin e praktikës për aksione interaktive qytetare.

Procesi i zbatimit të Kartelës për Vlerësimin e Bashkësisë përmban:

- Bërjen e listave me shërbime dhe mundësi të cilat i ofrojnë sektorët e ndryshëm në komunën e qytetarëve; Zhvillimin e temave kryesore dhe indikatorëve;
- Fokus grupe me përfaqësues të bashkësisë për përzgjedhjen e temave dhe indikatorëve;
- Përgatitjen e një instrumenti për evaluim me pikë;
- Fokus grupe për evaluim me përfaqësues nga bashkësia;
- Përpunimin e rezultateve;
- Përdorimin e rezultateve në krijimin e politikave dhe planifikimin.

Zbatimi i Kartelës për Vlerësimin e Bashkësisë si pjesë e analizës gjinore në procesin e krijimit të politikave të përgjegjshme gjinore është i rëndësishëm në disa nivele. Ai mundëson evaluimin e gjendjeve, nevojave, efikasitetit dhe qasshmërisë së shërbimeve dhe mundësive të cilat i ofron komuna për gratë dhe burrat e bashkësisë, pastaj mund të përdoret edhe si vegël për analizimin e programeve dhe ndikimit të tyre tek qytetarët. Nivel tjetër është ajo se mundëson pjesëmarrje të drejtpërsedrejtë të grave të bashkësisë, sidomos të grave nga grupet e marginalizuara sociale, në proceset e krijimit të politikave.

3.1.3 Planifikimi dhe buxhetimi i përgjegjshëm gjinor

Një nga temat më të rëndësishme për krijimin e politikave efektive gjinore është buxhetimi i përgjegjshëm gjinor. Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinor (BPGJ) paraqet rregullimin e politikave publike në të gjitha nivelet e procesit buxhetor dhe ristrukturimin e të ardhurave dhe shpenzimeve me ç'rast merren parasysh nevojat dhe prioritetet e grupeve të ndryshme të grave dhe burrave, duke patur parasysh rolet e tyre të ndryshme në familje, në ekonomi dhe në shoqëri. Mjetet shpërndahen në mënyrë që të mbahet llogari për avancimin e barazisë

së përfaqësimit gjinor në çdo nivel në procesin buxhetor dhe në çdo segment (infrastrukturë, mbrojtje të bashkësisë, ekonomi, arsim, sport, kulturë, etj.). Nga aspekti financiar, BPGj-ja nuk nënkupton privilegjin e një gjinie kundrejt tjetrës, por nënkupton insistim për trajtimin e barabartë të nevojave të posaçme të gjinive. Nga aspekti metodologjik, BPGj-ja nënkupton sensibilitet për nevojat e veçanta të gjinive (duke patur parasysh edhe kontekstin e tyre social, etnik apo çfarëdo konteksti tjetër), duke u nisur nga gjetja se i ashtuquajtimi neutralitet gjinor përfaqëson “verbëri” gjinore. Nga aspekti i target grupit, BPGj-ja mban llogari për nevojat e grupeve shoqërore, ndërsa nuk paraqet shpërblim të individëve sipas gjinisë. Gjithashtu, balansi ose disbalansi gjinor në buxhetim paraqet indikatorin më të qartë për prezencën ose mungesën e sensibilitetit gjinor në krijimin e politikave.

Konceptin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor, Republika e Maqedonisë filloi ta promovojë në vitin 2008, mbështetur nga Programi Rajonal për Buxhetim të Përgjegjshëm Gjinor të UN Women me inicjativë të Repartit për Mundësi të Barabarta pranë Ministrisë për Punë dhe Politikë Sociale. Qeveria në korrik të vitit 2012 solli Strategjinë për Buxhetim të Përgjegjshëm Gjinor i cili fokusohet në tri fusha:

1. Futjen e perspektivave gjinore në programin dhe në buxhetin në nivel qendror dhe lokal
2. Avancimin e kornizës ligjore për inkorporimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor
3. Forcimin e mekanizmave dhe kapaciteteve institucionale, të nevojshme për inkorporimin e perspektivës gjinore në krijimin e politikave dhe programeve të buxhetit

Në vitin 2012, Ligji për Mundësi të Barabarta të Grave dhe Burrave është i plotësuar edhe me reformën- buxhetim i përgjegjshëm gjinor, e cila detyrimisht i përcakton përgjegjësitë konkrete të institucioneve shtetërore dhe lokale. Kështu, në përputhshmëri me nenin 11 nga Ligji për Mundësi të Barabarta të Grave dhe Burrave: “Organet e administratës shtetërore e kanë për detyrë që në kuadër të planeve dhe buxheteve të tyre strategjike, të inkorporojnë parimin e mundësive të barabarta të grave dhe burrave; të ndjekin efektet dhe ndikimin e programeve të tyre tek gratë dhe burrat dhe të raportojnë për këtë në raportet e tyre vjetore.”³³

Në nivel nacional tashmë ka filluar zbatimi i kësajë detyre, të dalë nga Ligji, me analizën e procesit buxhetor nga perspektiva gjinore dhe me respektimin e detyrave nga cirkulari.

Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor në nivel lokal zbatohet përmes komunave

buxheti i të cilave përfshin plani i të ardhurave (të vazhdueshme dhe kapitale) dhe shpenzimet (çfarë do të finansohet- investime, tranfere, interes). Buxheti i komunës i pasqyron prioritetet dhe politikat e saj, ndërsa buxheti programor më shumë ka të bëjë me programin kundrejt shpenzimeve. Ai mundëson që të dihet qëllimi, rezultatet, indikatorët për sukses dhe përgjegjësi, e me këtë rrjedhimisht se sa nga programet do të jenë të ndjeshme për nevojat e ndryshme të qytetarëve. Përgjegjësinë për të zbatuar buxhetim të përgjegjshëm gjinor, në nivel lokal e kanë:

- Kryetarët e komunave;
- Shërbyesit shtetëror;
- Këshillëtarët e Këshillit të Vetëqeverisjes Lokale;
- Koordinatorët për mundësi të barabarta;

Organizatrat joqeveritare, partitë politike ose grupe të tjera jozyrtare të prekura (të cilat, gjithashtu, janë kyçura në procesin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor) Zbatimi i buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në nivel lokal e komplementon procesin e krijimit të politikave të përgjegjshme gjinore sepse mundëson që shpërndarja e resurseve të jetë në drejtim të arritjes së barazisë gjinore në bashkësi. Gjithashtu, ky proces e plotëson edhe procesin e analizës gjinore në pjesën e monitorimit të efekteve nga implementimi i politikave, aktiviteteve dhe shërbimeve dhe se sa ato i pasqyrojnë dhe ju përgjigjen nevojave, prioritetëve dhe interesave të burrave dhe grave në bashkësi.

Për fund, është e rëndësishme të kihet parasyshë metodologjia e cila përdoret në procesin e përforcimit të kapaciteteve. Pra, është e domosdoshme që të përdoren metoda interaktive dhe ushtrime me zbatimin e teknikave dhe veglave konkrete dhe të mundësohet përdorimi praktik i tyre i mëtutjeshëm.

Gjithashtu, është e rëndësishme që trajnimet t'i ndjekin dhe t'ju jenë mbështetje proceve të tjera gjatë krijimit të politikave në çdo fazë- përgatitje, analizë, hartim dhe miratim të politikave. Trajnimet duhet të kenë për bazë metodat e simulimit të nevojave reale të komunës, me ç'rast gjatë procesit të mësimt do të arrihen të identifikohen nevojat, të formulohen qëllimet dhe të propozohen mekanizmat dhe politikat.

3.2. Vendosja e bashkëpunimit dhe dialogut me përfaqësues të grupeve të rëndësishme, si dhe forimimi i grupeve punuese

Në modelin e krijimit dhe avancimit të politikave të përgjegjshme gjinore në njësitë e vetëqeverisjes lokale, krijimi i bashkëpunimit dhe dialogut me përfaqësues të grupeve relevante mendojmë se është aspekti më i rëndësishëm për vendosjen dhe thellimin e proceve demokratike të cilat janë në thelbin e procesit të decentralizimit dhe krijimit të kornizës për funksionimin e

vetëqeverisjes lokale. Në procesin e krijimit të politikave të përgjegjshme gjinore pjesëmarrja e grave dhe e burrave të bashkësisë, si dhe e avokuesve për barazi gjinore, është kyçe. Në pilot projektin i cili u realizua, bashkëpunimi dhe dialogu mes përfaqësuesve të komunave dhe qytetarëve zhvillohej në disa nivele: në procesin e përforcimit të kapaciteteve, në evaluimin e nevojave të qytetarëve dhe në procesin e krijimit të politikave. Në procesin e përforcimit të kapaciteteve përfaqësuesit e administratës komunale, Këshilli i Komunës gjegjësisht Komisioni për Mundësi të Barabarta të Burrave dhe Grave morrën pjesë së bashku me përfaqësuesit e organizatave joqeveritare lokale dhe me aktivistët. Ata mund të diskutonin dhe të punonin gjatë të mësuarit dhe përvetësimit të koncepteve për barazi gjinore dhe të këmbenit qëndrime dhe përvoja për mënyrën se si këto koncepte janë të rëndësishme për punën e tyre. Gjithashtu, ky proces ju mundëson që bashkëpunimi dhe dialogu të fillojë në një atmosferë të ndërtimit të një baze konceptuale e cila mëpastajë do të mbështesë dialogun e tyre dhe e cila do të mundësojë pozita më të fuqishme në proceset e përfaqësimit (avokimit) dhe negociatave të politikave të përgjegjshme gjinore në proceset institucionale dhe politike në nivel të bashkësisë lokale në fushat ku pushteti lokal ka kompetenca. Bashkëpunimi mes aktorëve të njejtë vazhdon edhe në procesin e evaluimit të nevojave dhe prioriteteve të cilat u formuan në grupe punuese të përbëra nga përfaqësues të të gjithë aktorëve relevantë në nivel lokal (administrata, Këshilli, qytetarët, organizatat). Në pilot projektin u tregua se grupet punuese janë bartësit kyç të procesit. Në to vendosej, përgatitej dhe ata e implementuan Kartelën për Vlerësimin e Bashkësisë. Grupet punuese i veçuan fushat kryesore prioritare për të cilat gratë nga shtresat e ndryshme sociale nga bashkësia i diskutuan si tema prioritare, pastaj grupet punuese i përcaktuan indikatorët të cilit ish-in të kyçura në vetë kartelat për vlerësim dhe bashkarisht i diskutuan rezultatet nga evaluimi i realizuar përmes fokus grupeve. Grupet punuese funksiononin si bashkësi e vogël në të cilën ish-in të kyçur edhe anëtarë shtesë për të cilët mendohej se është mirë që të kyçen, psh. në grupin punues të komunës së Gjorçe Petrovit në procesin e evaluimit të nevojave u kyçën shërbimet mobile për ndihmë sociale të cilat kanë njohuri më të mirë dhe janë në kontakt të vazhdueshëm me gratë nga shtresat më të ndjeshme (cënueshme) shoqërore. Duke marrë parasysh faktin se pikërisht gratë nga grupet më të cënueshme rrallë marrin pjesë në proceset publike dhe konsultimet, ky projekt dhe ky model e adreson pikërisht këtë mungesë dhe mundëson kyçjen e tyre në proceset e krijimit të politikave në bashkësinë e tyre lokale, që paraqet një cilësi shtesë të këtij modeli.

Në fund grupet punuese diskutuan rezultatet nga hulumtimi i realizuar me veglën Kartela për Vlerësimin e Bashkësisë dhe vendosën se cilën politikë/program do ta zhvillojnë/revidojnë dhe pastaj i krijuan politikat/programet. Gjatë këtyre diskutimeve dhe interpretimeve të rezultateve dolën prioritete të cilat pastaj u inkorporuan në programet. Kështu psh. si rezultat i evaluimit të Kartelës për

Vlerësimin e Bashkësisë ishte konstatimi se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që të kompletohen informatat për indikatorët sasior. Në këtë mënyrë grupet punuese nxorën në pah mungesën e të dhënave të ndara gjinore në komunat dhe pastaj grupi i komunës së Strumicës e vendosi këtë temë si njërin nga prioritetet e Programit të saj për Mundësi të Barabarta.

Grupet punuese ishin bërthama e tërë procesit të krijimit të politikave, aktiviteti i të cilëve në fund rezultoi me krijimin e progrmeve të reja për barazi gjinore në të cilat ishin të pasqyruara nevojat dhe prioritetet e grave të bashkësisë dhe të cilat fituan proektim buxhetor në buxhetin e komunës.

Përfitim shtesë nga vendosja e dialogut të përfaqësuesve të pushtetit lokal me qytetarët dhe organizatat qytetare dhe nga rezultati i procesit të përforcimit të kapaciteteve në domenin e avokimit dhe negociatave, është krijimi i kushteve demokratike në bashkësinë lokale për zbatimin efikas të politikave, mundësimi i shërbimeve të përshtatshme për qytetarët dhe marrja e përgjegjësisë nga ana e institucioneve të vetëqeverisjes lokale.

4. Rezultate nga aplikimi i modelit

4.1 Rrjedha dhe rezultate nga projekti “Përforcimi i kapaciteteve të vetëqeverisjes lokale dhe aktivistëve vendorë për krijimin e politikave efektive për barazi gjinore në R. e Maqedonisë”

Projekti u realizua në tre faza: Përforcimi i kapaciteteve, vendosja e dialogut dhe evaluimi i prioritetëve të qytetarëve dhe krijimi i politikave efektive gjinore.

Në fazën e parë të përforcimit të kapaciteteve u realizuan tre trajnime për konceptet themelore për barazi gjinore dhe për mënyrat e zbatimit të këtyre parimeve në procesin e krijimit të politikave gjinore relevante, pastaj trajnim praktik për planifikim të vetëdijëshëm gjinor dhe trajnim për buxhetim të përgjegjshëm gjinor dhe avokim (përfaqësim). Në trajnimet morrën pjesë përfaqësues nga administrata komunale, përfaqësues nga Këshilli i Komunës nga Komisioni për Mundësi të Barabarta të Burrave dhe Grave dhe përfaqësues nga OJQ-ët.

Faza e dytë filloi me formimin e grupeve punuese në komunat me përfaqësuesit e administratës komunale, përfaqësit e Këshillit të Komunës nga Komisioni për Mundësi të Barabarta të Burrave dhe Grave dhe përfaqësuesit e OJQ-ëve, dhe në atë mënyrë u fillua procesi i bashkëpunimit dhe dialogut mes përfaqësuesve të pushtetit lokal dhe institucioneve me përfaqësuesit e qytetarëve. Grupet punuese binin dakord dhe realizonin të gjitha hapat e veglës Kartela për Vlerësimin e Bashkësisë dhe në këtë mënyrë e zbatuan hulumtimin participativ për përcaktimin e nevojave dhe prioritetëve të grave nga shtresat e ndryshme sociale. Njerëzit nga bashkësia i vlerësonin shërbimet dhe dhënësit e shërbimeve

duke shfrytëzuar sistem të thjeshtë gradimi në formën e pikëve. U realizuan dy seri me fokus grupe me gra nga profile të ndryshme (për veçim të prioriteteve dhe për vlerësim) dhe nga një fokus grup me përfaqësues të administratës në të cilat u diskutuan çështje të lidhura me shërbimet dhe nevojat e qytetarëve në domenin e mbrojtjes sociale dhe në fusha të tjera në të cilat kompetencat i ka komuna.

Në fazën e tretë të projektit grupet punuese krijuan dokumente dhe politika për avancimin e barazisë gjinore. Grupet i analizuan rezultatet nga hulumtimi dhe zbatimi i Kartelës për Vlerësimin e Bashkësisë dhe u fokusuan në prioritete të cilat mund të inkorporohen në dokumentet programore të komunës. Grupi punues i Gjorçe Petrovit krijoi Program për Mundësi të Barabarta të Burrave dhe Grave në Komunë, e cila u mbështet nga Komisioni për Mundësi të Barabarta dhe u miratua në Këshillin e Komunës. Grupi punues i komunës së Strumicës krijoi Program për Mundësi të Barabarta të Burrave dhe Grave në Komunë, e cila u mbështet nga Komisioni për Mundësi të Barabarta, dhe është në proces e sipër për tu miratuar nga Këshilli i Komunës. Grupi punues i komunës së Bogovinës propozoi revizion të Programit për Mbrojtje Sociale me qëllim që të integrohet perspektiva gjinore dhe të harmonizohet me Planin Aksional aktual për barazi gjinore.

Indikatorë në Kartelën për Vlerësim

- Infrastruktura - Qasja e grave deri te infrastruktura bazë, shërbimet komunale (furnizimi me ujë, ndriçimi, transporti publik, kanalizimi)
- Mbrojtja sociale - Qasja e grave deri te shërbimet për mbrojtje sociale
- Ekonomia - Qasja e grave deri te programet për forcim ekonomik
- Kycja në marrjen e vendimeve – Kycja e grave në vetëqeverisjen vendore (bashkësitë lokale rurale/urbane):
 - a) Informimi i grave për zgjedhjen e përfaqësuesve të bashkësisë/vetëqeverisjes lokale/urbane
 - b) Kycja e grave në zgjedhjen e përfaqësuesve të bashkësisë/vetëqeverisjes lokale/urbane
- Bashkimi i grave - Mbështetje për gratë që të bashkohen (krijojnë shoqatë etj.)


Indikatorë sasiore

- Buxheti i përgjithshëm i komunës për vitin 2013
- Buxheti i komunës për infrastrukturë, arsim, mbrojtje sociale
- Numri i tregjeve
- Numri dhe lloji i institucioneve arsimore (private dhe publike)
- Numri dhe lloji i institucioneve për mbrojtje sociale (private dhe publike)
- Numri dhe lloji i institucioneve për mbrojtje shëndetësore (private dhe publike)
- Përqindja e grave me arsim fillor dhe të mesëm të paformuar (nga gjithsej numri i grave)
- Përqindja e grave nga bashkësitë joshumicë (psh. turke) me arsim të lartë (nga gjithsej numri i grave me arsim të lartë)
- Përqindja e vajzave me nevoja të posaçme të cilat nuk janë të kyçura në procesin arsimor
- Përqindja e grave që pranojnë ndihmë sociale (të gjitha llojet)
- Numri i programeve/projekteve për punësimin e grave të cilat i realizon komuna
- Përqindja e grave nga numri i gjithsejtë i pjesëmarrësve në forumet e bashkësisë
- Përqindja e grave në Këshillin e Komunës
- Përqindja e grave në pozitat udhëheqëse të komunës

4.2. Rezultate nga Kartela për Vlerësimin e Bashkësisë– Community Score Card (CSC)

Rezultatet janë të shfaqura në mënyrë grafike, ngjajshëm si vetë kartelat për vlerësim të cilat u përdorën në fokus grupet me gratë dhe me administratën. Meqë bëhet fjalë për të dhëna cilësore, informata plotësuese nga konteksti i shoqërojnë grafikonet. Në disa nga grafikonet veçmas shfaqen vlerësimet e fokus grupit të grave dhe atij me përfaqësues të administratës, që të shfaqen dallimet në vlerësimin e gjendjes reale mes dy target grupeve që marrin pjesë në procesin e evaluimit. Është e rëndësishme të theksojmë se në këtë analizë nuk janë të futura ato pak të dhëna sasiore të cilat i dorëzuan komunitat për indikatorët sasiore, për shkak të mungesës së të dhënave statistikore të ndara sipas gjinisë, por gjithashtu, është i vlefshëm fakti se kjo mungesë ishte nxitje për të menduar për mënyrë se si në komuna të futet praktika e mbajtjes së të dhënave të veçuara sipas gjinisë dhe të propozohen aktivitete në politikën e re e cila u krijua.

Infrastrukturë – qasje e femrave deri te infrastruktura themelore – shërbimet komunale (furnizim me ujë,ndriçim,transport publik,kanalizim)



Shumica e femrave kanë qasje deri te infrastruktura themelore,por jo për të gjitha shërbimet Në disa pjes të komunës dhe disa femra (më së shpeshti nga grupet e cenushme shoqerore) kanë qasje të kufizuar ose nuk kanë qasje deri te disa nga shërbimet. Për shembull femrat nga Bogovina nuk kanë infrastrukturë për kanalizim dhe në disa pjesë të komunës ka problem me furnizimin e ujit

Sigurim shoqëror – qasje e femrave deri te shërbimet shoqërore (çerdhe,shtëpi për pleq,kujdes për të paaftit,shërbime për fëmijë me aftësi të kufizuara,mbrojtje nga dhuna familjare...)

Nivele	1	2	3	4	5
Në komunën nuk ka shërbime dhe gratë nuk kanë qasje deri te shërbimet për sigurim shoqëror	●				
Në komunën egzistojnë disa shërbime për sigurim shoqëror,por nuk janë të qëndrueshëm dhe një pjesë e vogël e femrave kanë qasje deri te ato shërbime		●			
Egzistojnë disa shërbime të cilat mundëson komuna të cilat përmbushin një pjesë të nevojave dhe nuk kanë të gjitha femrat qasje deri te ato			●		
Komuna mundëson shërbime të ndryshme por nuk janë pjesë e programit të komunës dhe nuk ndahen mjete te mjaftueshme nga buxheti i komunës					
Në komunën ka politikë për sigurim shoqëror dhe mjaft programe dhe shërbime, dhe të gjitha femrat kanë qasje deri te ato					

- Bogovin
- Gjorce Petrov
- Strumic
- Femra
- Administrata

• Në Bogovin nota më e ulët është 1,sepse femrat nuk kanë qasje deri te shërbimet sikur : Çerdhe,kujdesi për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe kujdesi për të moshuarit,mbrojtje nga dhuna familjare etj.

• Në Strumic dhe Gjorce Petrov femrat notuan me 2 , ndërsa administrata me 3,megjithatë të dy grupet ranë dakord se egziston mungesë për disa shërbime shoqërore të rëndësishme,poasqërisht për femrat nga grupet e cënueshme


Arsimi – programe për përfshirjen e vajzave nga komunitetet të marginalizuar dhe pakic në procesin e arsimit (fillor dhe të mesëm)

Nivele	1	2	3	4	5
Në komunën nuk ka programe për përfshirjen e vajzave nga grupet e cenueshme dhe ato nuk janë të përfshira në procesin e arsimit	●				
Në komunën vetëm në disa shkolla ka programe të cilët nuk mundësojnë përfshirjen e pjesës më të madhe të vajzave nga grupet e cenueshme në procesin e arsimit		●			
Komuna/shkollat kanë disa loj programe për përfshirjen e vajzave nga komunitetet pakic dhe të marginalizuar në procesin e arsimit dhe pjesa më e madhe përfshihet përveç për...			●		
Në komunën shumica e vajzave nga komunitetet me pakic dhe të marginalizuar janë të përfshira në procesin e arsimit, por ajo nuk është e qendrueshme dhe nuk ndahen mjete nga buxheti I komunës.				●	
Në komunën ka programe/politika për përfshirjen e vajzave nga komunitetet me pakic dhe të marginalizuar dhe ato janë të përfshira në procesin e arsimit					

- Bogovin
- Gjorce Petrov
- Strumic
- Femra
- Administrata

- Në Bogovin rezultatet janë më të ulta me notën 1 në të dy fokus grupet, sepse nuk egzistojn programe për përfshirjen e vajzave nga grupet e cenueshme në procesin e arsimit
- Në Strumic FG me femra nota 2 dhe FG me administratë nota 3, sepse egzistojnë disa iniciativa dhe projekte për përfshirje por disa/shumica e vajzave nuk kanë qasje deri te ato.
- Në Gjorce Petrov vetëm administrata dha notë për këtë tregues, sepse femrat në fokus grupin nuk mundeshin të japin mendim. Administrata dha notë të madhe 4 e cila tregon se shumica e vajzave nga grupet e cenueshme janë të përfshira në procesin e arsimit

Ekonomia – Qasje e femrave deri te programet për forcimin ekonomik



Përfshirje në sjelljen e vendimeve – informimi i femrave për zgjedhjen e përfaqesuesëve të bashkësisë/vetëqeverisjes lokale/urbane



Përfshirja në marjen e vendimeve – Përfshirja e femrave në zgjedhjen e përfaqësuesve të bashkësisë/vetëqeverisjes lokale/urbane

Nivele	1	2	3	4	5
<p>Komuna nuk i inkurajon femrat të përfshihen në zgjedhjen e përfaqësuesve të bashkësisë lokale – nuk egzistojn mekanizma të vacantë, masa për nxitjen e femrave. Femrat nuk përfshihen në marjen e vendimeve (zgjedhja e përfaqësuesve të bashkësisë lokale).</p> <p>Komuna rastësisht i përfshin femrat – vetëm kur egziston problem i mprehtë aktual me të cilin janë të ndikuara drejtpërsëdrejti.</p> <p>Komuna i përfshin vetëm ato femra të cilat janë aktive në partitë politike, OJQ, biznes</p>		●			
<p>Komuna në bashkëpunim me OJQ zbaton projekte për nxitjen e femrave për përfshirjen në procesin e vendim-marjes</p> <p>Përfshirje sistematike – egzistojn dispozita për përfshirjen e femrave në statutin e komunës</p>			●		

- Bogovin
- Gjorçe Petrov
- Strumic
- Femra
- Administrata

• Nota më e ulët në bogovin 2 pavarësisht nga përpjekjet për përfshirjen e femrave në procesin e vendim-marjes pjesëmarja ende është e ulët

• Në Strumic dhe Gjorçe Petrov nota më e ulët 1 në FG me femra dhe notë mesatare 3 në FG me administratën siç përmenda më parë femrat kanë qendrimë dhe informata të ndryshme në lidhje me administratën e cila është e lidhur drejtpërsëdrejti me proceset e vendim-marjes.

Bashkimi I femrave në komunën* – përkrahje femrave për bashkim

Nivele	1	2	3	4	5
Komuna nuk I përkrah femrat të bashkohen në çfardo baze (përkrahje, socijalizim, forcim ekonomik, veprim I përbashkët, promovim dhe ngjajshem.)					
Komuna rastësisht I përkrah femrat të bashkohen si pjes e ndojnje iniciative afatshkurte					
Komuna I përkrah inicijativat e femrave të bashkohen por ato nuk janë të përfshira në realizimin e tyre					
Komuna në bashkëpunim me OJQ zbaton projekte për bashkimin e femrave					
Komuna ka program për përkrahjen e iniciativave për bashkimin e femrave					●

- Bogovin
- Gjorce Petrov
- Strumic
- Femra
- Administrata

* Tregues specifik për komunën e Bogovines.

Rezultate të përmbledhura nga kartela për vlerësim:

- Gratë nga bashkësitë lokale, sidomos ato nga shtresat më të ulta sociale kanë nevojë për shërbime më të mira në domenin e mbrojtjes sociale
- Nevojitet informim më i mirë për mundësitë dhe shërbimet nëpër komunitet, për mundësitë e forcimit ekonomik të grave dhe për kyçjen e tyre në proceset e marrjes së vendimeve në nivelin e bashkësisë vetëqeverisëse- në bashkësitë urbane dhe rurale
- Nevojitet përmirësimi i kushteve në bashkësinë lokale për kyçjen e vajzave nga grupet e ndjeshme/cënueshme (bashkësitë etnike pakicë, dhe fëmijë me nevoja të veçanta)
- Nevojitet mbështetje dhe strategji për kyçjen e grave në proceset e marrjes së vendimeve në nivel lokal dhe në projektet të cilat kanë të bëjnë me forcimin ekonomik të qytetarëve.
- Forcimi i mëtutjeshëm i kapaciteteve të administratës së komunës është i nevojshëm që të mundësohet implementimi i detyrave ligjore për kyçjen e perspektivës gjinore në dokumentet dhe politikat e komunave.
- Është e nevojshme mbajtje e evidencës dhe statistikës së veçuar gjinore nëpër komuna.

Rekomandime të cilat dolën nga fokus grupet me gratë:

- Të flitet dhe të edukohen më shumë për barazinë gjinore
- Të përmirësohet infrastruktura në ca pjesë të komunave (kryesisht në pjesët rurale)
- Të përmirësohen shërbimet sociale për strehimin dhe kujdesin për personat më të moshuar dhe për personat me hendikep
- Të përmirësohet transporti publik për rrethet rurale

Rekomandime të cilat dolën nga fokus grupet me përfaqësues të administratës:

- Kyçja e grave në proceset e vendimmarrjes në nivel lokal
- Përmirësimi i informatave për gratë për proceset e vendimmarrjes në nivel lokal dhe për beneficionet dhe shërbimet sociale që janë në kompetencat e komunës
- Promovimi i barazisë gjinore

5.Konkluzione dhe rekomandime

Zbatimi i ligjeve në nivel lokal që kanë të bëjnë me barazinë gjinore si dhe dokumentet e tjera normative, si dekretet, strategjitë etj. , në nivel lokal varet nga a) arritja e njohjes së domosdoshmërisë për formulimin e politikave institucionale nga aspekti procedural dhe programor, nga b) kapacitetet e administratës që të formulojë politika efektive, edhe nga c) vlerësimi i sakt i nevojave në teren (needs assesment).

Hulumtimi dhe përvoja nga realizimi i projektit solli konkluzionet në vijim:

- Administrata e vetëqeverisjes lokale posedon njohuri modeste për vetë konceptin e ndërtimit të politikave dhe kapacitete dhe shkathtësi akoma më modeste për krijimin e tyre.
- Administrata në nivel lokal ka nevojë për ngritjen e vetëdijes për integrimin e perspektivës gjinore në politikat programore dhe buxhetore sepse nuk e kupton mjaftueshëm rëndësinë e saj.
- Administrata në nivel lokal detyrimet për krijimin e politikave dhe buxhetimit të përgjegjshëm gjinor i përjeton si ngarkesë poqese nuk është e bindur për rëndësinë e kësajë çështjeje dhe poqese mungon interaksion i vërtetë me sektorin qytetar, i cili i përfaqëson nevojat e posaçme.
- Egziston nivel i ulët i kërkesës ose artikulimit të nevojave dhe prioriteteve të grupeve të prekura të qytetarëve lidhur me çështjet gjinore dhe nevojë për vendosjen e dialogut mes organizatave joqeveritare dhe administratës së vetëqeverisjes lokale.
- Nga evaluimi i zbatuar me ndihmën e Kartelës për Vlerësimin e Bashkësive zbulojmë se gratë e bashkësive lokale, sidomos ato nga shtresat më të ulta sociale kanë nevojë për shërbime më të mira në domenin e mbrojtjes sociale, informim më të mirë për mundësitë dhe shërbimet e komunave, për mundësitë e forcimit ekonomik të grave dhe për kyçjen e tyre në porceset e vendimmarrjes në nivelin e vetëqeverisjes së bashkësisë- në bashkësitë urbane dhe rurale.

Rrjedhimisht, rekomandojmë:

1. Përvetësimin e një programi edukativ, me model të vetin të trajnimeve, i cili do të ofrojë ngritjen e kapaciteteve; dhe model për qëndrueshmërinë e tyre dhe për investimin e vazhdueshëm në forcimin e kapaciteteve të njësive të vetëqeverisjes lokale për krijimin e politikave-si shkathtësi që mund të përçohet, dhe për krijimin e politikave të përgjegjeshme gjinore- si shkathtësi të veçanta (specifike) sa i përket përmbajtjes.
2. Trajnime për përforcimin e vetëdijes sa i përket barazisë gjinore dhe krijimit të politikave të përgjegjeshme gjinore për përfaqësuesit e vetëqeverisjes lokale si mekanizëm për vendosjen e një shoqërie inkluzive.
3. Zbatimin e diskutimeve, simulimeve dhe punës praktike në trajnimet, të bazuara në procese dhe aktivitete të vërteta në vetëqeverisjen lokale që do të mundësojë: a) ngritjen e kapaciteteve dhe forcimin e shkathtësive, b) zbatimin e njohurive të sapofituara në krijimin e dokumenteve për politika të arritshme (policy documents).
4. Kyçjen e analizës gjinore dhe përdorimin e veglës Kartela për Vlerësimin e Bashkësisë (CSC: Community Score Card) në procesin e krijimit të politikave senzitive gjinore për shkak të përcaktimit të nevojave dhe prioriteteve të grave dhe burrave të bashkësisë lokale si dhe mundësimin të procesit të futjes së perspektivës gjinore në rrjedhat kyçe, politikat dhe praktikat (gender mainstreaming).
5. Kyçjen e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në proceset e forcimit të kapaciteteve dhe në procesin e krijimit të politikave në vetëqeverisjen lokale. Në këtë mënyrë do të kontribuohet për zvoglimin e hendekut gjinor dhe pabarazisë gjinore.
6. Aftësimin për dialog dhe negociata të sektorit joqeveritar, si avokues (përfaqësues) i nevojave të grupeve shoqërore (në këtë rast, grave) që do të mundësojë a) demokraci participative në marrjen e vendimeve, dhe b) vlerësimin e nevojave të bazuara në dëshmi (evidence based) të dala nga shkëmbimi i drejtpërdrejtë me një publik të informuar dhe përfaqësues.
7. Forcimin e kapaciteteve të sektorit qytetar për avokim (përfaqësim) dhe negociim që të mundësohet artikulimi i kërkesave dhe pozita e grupeve të prekura të qytetarëve nga bashkësia lokale, dhe njëherit të nxitet efikasiteti, dhënia e llogarisë, dhe marrja e përgjegjësisë nga institucionet e vetëqeverisjes lokale për zbatimin e Ligjit për Mundësi të Barabarta të Grave dhe Burrave.

Referenca:

¹ Strategy for equality between women and men 2010-2015, European Commission, COM(2010) 491 final, (Brussels, 21.9.2010)

² A strategy for smart, sustainable and inclusive growth EUROPE 2020, European Commission (Brussels, 3.3.2010), COM(2010) 2020 final, e disponueshme në: <http://eurlex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=COM:2010:2020:FIN:EN:PDF>, qasur më 4.3.2014.

³ Deklarata e Pekinit dhe Platforma për Aksion, revidimi i fundit i disponueshëm në: <http://www.un.org/womenwatch/daw/beijing15/index.html>, qasur më 20.3.2014

⁴ Sesioni i fundit i Komisionit për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave, e disponueshme në: <http://www.unwomen.org/en/csw/csw58-2014>, qasur më 20.3.2014

⁵ Concluding comments of the Committee on the Elimination of Discrimination against Women: the former Yugoslav Republic of Macedonia, 2006, e disponueshme në: <http://www.un.org/womenwatch/daw/cedaw/cedaw34/concludingcomments/FYROMcc.pdf>

⁶ Concluding observations on the combined fourth and fifth periodic reports of The former Yugoslav Republic of Macedonia adopted by the Committee at its fifty fourth session (11 February – 1 March 2013) e disponueshme në: <http://www2.ohchr.org/english/bodies/cedaw/docs/co/CEDAW.C.MKD.CO.4-5.pdf>, 2013

⁷ Strategjia për Barazi Gjinore 2013-2020, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, Shkup 2013 („Gazeta zyrtare“: Shkup 2013), <http://www.slvesnik.com.mk/Issues/9d01686c914343d28b15b2605b82272b.pdf>, пристапено на 2 април 2014.

⁸ Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, i disponueshme në <http://www.sobranie.mk/ustav-na-rm.nsp> qasur më 2 prill 2014

⁹ Ligji për Mundësi të Barabarta të Grave dhe Burrave (Gazeta Zyrtare e RM-ës nr.66/06 më 29.05.2006).

¹⁰ Ligji për Mundësi të Barabarta të Grave dhe Burrave (Gazeta Zyrtare e RM-ës, nr.6/2012 më 13.1.2012).

¹¹ Ligji për Ndalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi (Gazeta Zyrtare e RM-ës, nr. 50 më 13.04.2010).

¹² Ligji për Mardhënie Pune (tekst i pastruar) (Gazeta Zyrtare e RM-ës, nr.34 më 17.02.2014).

¹³ Kodi Zgjedhor (tekst i pastruar), Komisioni juridiko-ligjvënës i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë (Nr. 10-2091/2, 14 prill i vitit 2011, Shkup).

¹⁴ Ibid., 7

¹⁵ Report on Progress on Equality between Women and Men in 2010 - The gender balance in business leadership, Luxembourg: Publications Office of the European Union, 2011.

¹⁶ Popullsia aktive e Republikës së Maqedonisë: Rezultate nga Sondazhi për fuqi punëtore, (Tremujori i III-të i vitit 2013, Enti Shtetërorë për Statistikë në Republikën e Maqedonisë), i disponueshëm në: <http://www.stat.gov.mk/pdf/2013/2.1.13.33.pdf>, qasur më 3.3.2014 година.

¹⁷ Raport nga monitorimi i politikave për barazi gjinore në R. e Maqedonisë, (Akcija Zdrzhenska, dhjetor 2010, Shkup).

¹⁸ Analizë buxhetoro-gjinore e mbrojtjes sociale dhe politikave aktive për punësim në Republikën e Maqedonisë- (Ministria për Punë dhe Politikë Sociale, 2010).

¹⁹ Ibid. 17

²⁰ Ibid. 7 listë e kryetarëve të komunave në Republikën e Maqedonisë e disponueshme në <http://www.zels.org.mk/default.aspx?modules=mayorlist> qasur më 02.04.2014

²¹ Informata në lidhje me konkluzionin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për gjetjet e analizës për pjesëmarrje cilësore të grave në jetën publike dhe politike në njësitë e vetëqeverisjes lokale, (Ministria për Punë dhe Politikë Sociale, Shkup, nëntor i vitit 2011). të disponueshme në <http://www.mtsp.gov.mk/?ItemID=463B79E2DAE454468BBCDFEC8D2D7845>, qasur më 02.04.2014

²² Analizë për shkallën e implementimit të ligjit për mundësi të barabarta të grave dhe burrave, Ministria për Punë dhe Politikë Sociale në Republikën e Maqedonisë, (2011, Shkup), http://www.mtsp.gov.mk/WBStorage/Files/analiza_zem.pdf, qasur më 2 prill 2014.

²³ The Global Gender Gap Report 2012, World Economic Forum, disponueshëm në http://www3.weforum.org/docs/WEF_GenderGap_Report_2012.pdf, qasur më 2 prill 2014.

²⁴ Risto Karjakov dhe tjerë, Indeks i përfshirjes shoqërore në nivel lokal, (Evro-Balkan press, 2011, Shkup) i disponueshëm në http://www.euba.edu.mk/tl_files/Publikacii%20EUBA/Indeks%20na%20sociojalna%20inkluzija%20-%20WEB.pdf, qasur më 2 prill 2014

²⁵ Marija Savovska, Monitorimi i zbatimit të Ligjit për Mundësi të Barabarta të Grave dhe Burrave në kuadër të vetëqeverisjes lokale në Republikën e Maqedonisë, (Akcija Zdruzhenska, 2009, Shkup)

²⁶ Ibid. 25

²⁷ Strategjia Nacionale për Zvoglimin e Varfërisë dhe Përrjashtimit Social në Republikën e Maqedonisë (reviduar 2010-2020), Ministria për Punë dhe Politikë Sociale në Republikën e Maqedonisë, e disponueshme në http://www.mtsp.gov.mk/WBStorage/Files/revidirana_str_siromastija.pdf qasur më 3.3.2014.

²⁸ Ibid.27

²⁹ The Feminization of Poverty, e disponueshme në: <http://www.un.org/womenwatch/daw/followup/session/presskit/fs1.htm>

³⁰ Community Score Card Process - A Short Note on the General Methodology for Implementation, the Social Development Department at the World Bank <http://siteresources.worldbank.org/INTPCENG/1143333-1116505690049/20509286/comscorecardsnote.pdf>

³¹ Community Score Card Process - A Short Note on the General Methodology for Implementation, the Social Development Department at the World Bank <http://siteresources.worldbank.org/INTPCENG/1143333-1116505690049/20509286/comscorecardsnote.pdf>

³² Azra Hadzahmetovic dhe tjerë “Community Based Scorecards: A Manual for Civil Society”, UN Women, 2012, Tirana

³³ Strategji për Futjen e Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjinor në Republikën e Maqedonisë 2012-2017, (Ministria për Punë dhe Politikë Sociale në Republikën e Maqedonisë, 2012, Shkup) e disponueshme në http://e-demokratija.mk/socijalni_raboti/-/document_library_display/5b6U/view/26941/4602;jsessionid=31B0314087D7687DD77607F5BE2588A2, qasur më 2 prill 2014

DIALOG

PROCES

PËRFORCIMI

KRIJIMI

POLITIKAVE

EFEKTIVE

GJINORE

QYTETARËT

KOMUNITET

MODEL

KOMUNITET

KRIJIM